



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d dhe të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/040 nenin 11 pika 1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144, dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2014, miratoi këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E INICIMIT TË PROCEDURËS PËR KËMBIMIN E PRONËS KOMUNALE NË EMËR TË SHFMU “KADRI KADRIU” ME PRONËN PRIVATE

Neni 1

Lejohet iniciimi i procedurës për këmbimin e pronës Komunale – Shoqrore në emër të Shkollës Filllore “Kadri Kadriu” evidentuar sipas parcelës kadastrale nr.1165-0, kultura livadh, klasa e 5, vendi i quajtur “Lagja e Thofcve” , në sipërfaqe prej 0.48.91 ha, me pronën private të evidentuar sipas parcelës kadastrale nr. 1164-0 me sipërfaqe prej 0.71.78 ha zona kadastrale Dumnicë e Epërme.

Këmbimi – ndrimi bëhet në përpjestim të barabartë për arsye të vlerës (bonitetit) të njejtë, kultura bujqësore klasa e 5, parcela kadastrale fqinje.

Neni 2

Komuna është përgjegjëse dhe kujdeset për këmbimin e pronës Komunale – titullar i së cilës është sipas Certifikatës nr. P-71712017-011165-0 me pronën private pronar i së cilës është Salih Ukë Uka sipas Certifikatës nr. P-71712017-01164-0 nga fshati Dumnicë e Epërme, duke zbatuar të gjitha procedurat që ndërlidhen me ndrrimin e pronave në mes të Komunës në njërin anë dhe Salih Ukë Ukës në anën tjetër konform pikës 2.1 të nenit 11 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nr. 04/L-144.

Neni 3

Arsyeja e ndërrimit të parcelave është që Objekti Shkollor i ndërtuar në fshatin Dumnicë e Epërme me pëlqimin e pronarit është ndërtuar në parcelën e tij private nr.1164-0 me qëllim të mos ndërprerjes së procesit mësimor, që do të pasonte nëse do të rrënohej Shkolla e vjetër për ndërtimin e Shkollës së re në parcelën kadastrale nr. 1165 -0 pronë komunale.

Neni 4

Zbatimin e këtij Vendimi e bëjnë, Drejtoria e Pronës Kadastrës dhe Gjeodezisë, dhe Drejtoria e Arsimit.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-350-82167
Podujevë,
29 shtator 2014



Kryesuesi i Kuvendit
Mebrmet Gashi